

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6457
E premte, 5 nëntor 2021
çmimi 0.40 €

Vaksinimi në Kosovë mund të bëhet pa termin



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA SPECIALE NJË VJET MË PARË KISHTE NGREHUR AKTAKUZËN PËR ISH-KRERËT E UÇK-së

NJË VJET PADREJTËSI NDAJ ISH-UDHËHEQËSVE TË UÇK-së



Sot, më 5 nëntor, bëhet një vjet qëkur Dhomat e Specializuara në Hagë kanë konfirmuar aktakuzën ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Ndonëse është bërë një vjet që Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në paraburgim, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ende nuk ia ka dorëzuar mbrojtjes dosjen paraprake dhe nuk dihet se kur do të fillojë shqyrtimi kryesor i këtij procesi. Avokatët e ish-komandantëve të UÇK-së kanë vlerësuar se klientët e tyre po mbahen qëllimisht në paraburgim. Ata kanë bërë me dije se kjo gjykatë është ndërtuar mbi gënjeshtër dhe se procesi ndaj klientëve të tyre është i padrejtë

"BALLKANI I HAPUR", KËRKOHET ZBATIMI I MARRËVESHJEVE TË ARRITURA



HASHIM THAÇI, I MUNGUARI I MËDH I KOSOVËS

Shkruan: Ismail SYLA

AKTUALE



BRITANIA MIRATON PILULËN E PARË KUNDËR COVID-19

BE-JA PËRSËRIT: KOSOVA T'I ZBATOJË MARRËVESHJET

KËRKOHET PARABURGIM NDAJ PESË TË PANDEHURVE PËR FALSIFIKIM TË PARAVE

EKONOMI



APROVIMI I PJESSHËM I ANKESAVE NË OSHP DËMTOI BUXHETIN E KOSOVËS MBI 246 MIJË EURO

SHTOHEN ANKESAT E KONSUMATORËVE PËR NGRITJEN E ÇMIMEVE

SPORT



'DARDANËT' DO TË PËRBALLEN ME NORVEGJINË DHE DANIMARKËN

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania miraton pilulën e parë kundër Covid-19

LONDËR, 4 NËNTOR - Pilula e parë, e krijuar për t'i trajtuar simptomat e sëmundjes Covid-19, është miratuar nga rregullatori i barnave në Britaninë e Madhe.

Tableta Molnupiravir do t'u jepet dy herë në ditë pacientëve të infektuar e që rrezikohen të vdesin nga infeksioni.

Në provat klinike, pilula, e krijuar fillimisht për trajtimin e gripit, ka përgjysmuar rrezikun e shtrimit në spital ose të

vdekjes.

Sekretari britanik i Shëndetësisë, Sajid Javid, tha se trajtimi është një "ndryshues loje" për njerëzit me imunitet të dobët. "Sot është një ditë historike për vendin tonë, pasi Britania e Madhe është tashmë vendi i parë në botë që miraton një antiviral për sëmundjen Covid-19, që mund të merret në shtëpi", tha Javid.

Molnupiravir, i zhvilluar nga kompanitë amerikane të barnave Merck, Sharp dhe

Dohme (MSD), si dhe nga Ridgeback Biotherapeutics, është medikamenti i parë antiviral për Covid-19, që mund të merret si pilulë, në vend që të injektohet ose të jepet në mënyrë intravenoze. Britania e Madhe ka rënë dakord që të blejë 480 000 kuti, ndërsa dërgesat e para pritet t'i arrijnë kah mesi i nëntorit.

Pilula duhet të jepet brenda pesë ditësh nga zhvillimi i simptomave, për të qenë më efektive.



Turqia po i heton postimet në rrjetet sociale për shëndetin e presidentit

ANKARA, 4 NËNTOR - Autoritetet turke kanë nisur një hetim ndaj 30 personave të cilët akuzohen se kanë postuar dezinformata në rrjetet sociale për shëndetin e presidentit Rexhep Tajip Erdogan. Policia turke ka njoftuar se këta persona kanë postuar "përmbajtje manipuluese" në rrjetin social "Twitter" duke përdorur hashtagun - olmous (i vdekur).

Ky hashtag filloi të përdorej derisa spekulimet për shëndetin e Erdoganit janë në rritje. Bashkëpunëtorët e tij janë munduar t'i shuajnë këto spekulime duke shpërndarë imazhe të aktiviteteve të tij. Spekulimet për shëndetin e tij kanë qarkulluar prej vitesh. Politikanët rivalë që kundërshtojnë qeverinë e Erdoganit shpesh e kanë vënë në pikëpyetje shëndetin e presidentit.



Erdogan, 67 vjeç, iu nënshtua një operacioni në zorrë në vitin 2011. Në vazhdimësi, presidenti turk ka mohuar raportet se kishte kancer. Të mërkurën Erdogani mori

pjesë në disa ngjarje në kryeqytetin Ankara për të shënuar 19-vjetorin e ardhjes në pushtet të partisë së tij konservatore. "Shefi ka mbërritur nga Stambolli në

Ankara. Ai është shumë i shëndetshëm", ka shkruar një anëtar i Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP), Ahmet Hamdi Camli. Mediat turke thonë se

spekulimet për shëndetin e zotit Erdogan u nxitën nga një video që tregonte presidentin duke ecur me vështirësi të premtën e kaluar.

Muajin e kaluar, kur spekulimet për shëndetin e Erdoganit morën hov, zyra e tij për komunikim publikoi një video të presidentit duke luajtur basketboll.

Erdogani shpesh shfaqet në publik dhe mban shumë fjalime në ditë. Së fundmi ai udhëtoi në Afrikë për një turne treditör, si dhe në Romë për samitin e G20-s të liderëve botërorë.

Erdogani ka dominuar në politikën turke për dekada. Ai ishte kryeministër nga viti 2003 deri më 2014, ndërsa postin e presidentit e mban që nga viti 2014.

Zgjedhjet e ardhshme presidenciale turke do të mbahen në vitin 2023.

Emetimi i karbonit është kthyer në nivelet e parapandemisë

Moskë, 4 nëntor - Në vitin 2021 nivelet e emimit të dyoksidit të karbonit (CO2) në botë janë kthyer në ato që ishin para pandemisë, sipas një studimi të publikuar më 4 nëntor. Të dhënat u bënë publike nga konsorciumi "Global Carbon Project", një grup shkencëtarësh që hulumtojnë ndryshimet klimatike.

Raporti u bë publik në konferencën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) që po mbahet në Glasgow të Skocisë.

Në vitin 2020, sipas shkencëtarëve, emetimet e CO2 ranë me një rekord prej 1.9 miliardë tonësh, apo 5.4 përqind pasi vendet vendosën

masa të izolimit.

Ajri më i pastër në shumë prej qyteteve të mëdha rriti shpresat se bota ishte në rrugë të duhur për reduktimin e ndotjes nga karboni.

Por, shkencëtarët thonë se nuk ishte kështu.

Raporti parashikon që emetimet e vitit 2021 do të tregojnë një rritje prej 4.9-përqindësh. "Ajo që na befaso i ishte intensiteti dhe shpejtësia e rikthimit", tha autori kryesor i raportit, Pierre Friedlingstein, një studiues i klimës në Universitetin e Exeter në Britaninë e Madhe.

Qëllimi i konferencës për klimën që po mbahet në Glasgow është që të gjejë

mënyra për ta kufizuar rritjen e temperaturës në 1.5 gradë celsius mbi nivelet paraindustriale dhe për t'i shmangur efektet katastrofike të ndryshimeve klimatike.

Për ta bërë këtë, shkencëtarët thonë se emetimet e CO2 duhet të arrijnë zero deri në vitin 2050.

Raporti theksoi një rritje në emetimet e karbonit që bën Kina, duke thënë se ky vend, këtë vit, do të përfshijë gati një të tretën e prodhimit të dyoksidit të karbonit në nivel global.

Shifrat bazohen në të dhënat nga qeveritë për përdorimin e energjisë, udhëtimin, prodhimin industrial dhe



faktorë të tjerë.

Raporti kishte edhe disa të dhëna pozitive. Për shembull, 23 vende që përbëjnë një të katërtën e emetimeve globale gjatë dekadës së fundit, duke

përfshirë Shtetet e Bashkuara, Japoninë, Gjermaninë, Francën dhe Britaninë, shënuan rënie të emetimeve pavarësisht prej rritjes ekonomike.

“Ballkani i hapur”, kërkohet zbatimi i marrëveshjeve të arritura

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Zbatimi i marrëveshjeve politike në praktikë, posaçërisht i marrëveshjes për lëvizjen e mallrave, ishte mesazhi kryesor nga takimi trepalësh i nismës rajonale për bashkëpunim “Ballkani i hapur”, ku janë të përfshira Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Kjo nismë parasheh lëvizjen e lirë të kapitalit, mallrave, shërbimeve dhe njerëzve mes këtyre tri vendeve.

Në Beograd më 4 nëntor është mbajtur takimi i radhës i udhëheqësve të nismës rajonale për bashkëpunim “Ballkani i hapur”. Në takim morën pjesë presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, zëvendëskryeministri për çështje evropiane i Maqedonisë së Veriut, Nikolla Dimitrov, si dhe afaristë nga rajoni.

Presidenti Vuçiq tha se do të formohet një këshill i zbatimit të marrëveshjeve të arritura për përbërjen e të cilit do të vendoset në vazhdim. “Puna jonë është të shohim se ku kemi ngecur në praktikë”, tha ai në një konferencë të përbashkët për media, duke shtuar se është frustruese që marrëveshjet në nivelin politik nuk janë implementuar në tërësi. Në 7 deri në 10 ditë e ardhshme do të kemi takime me përfaqësues të doganave, agjencive të ndryshme dhe inspektiveve fitosanitare për të parë se si po shkon qarkullimi i lirë i mallrave dhe shërbimeve”, tha Vuçiq.

Ai shpjegoi se qëllimi është që të hiqen pengesat në transportin e mallrave. “Kur të merret deklarata doganore në Suboticë dhe Beograd, nuk ka pse ju ndal dikush në doganën e Maqedonisë së Veriut dhe të shkoni më tej drejt Tiranës”, theksoi Vuçiqi.

Takimit të udhëheqësve të tri shteteve i ka paraprirë një takim me përfaqësues të kompanive nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Vuçiqi shtoi se afaristët qind për qind e mbështetën këtë iniciativë, porse kërkohet zbatimin më të shpejtë (të marrëveshjeve).

Në këtë takim morën pjesë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, i ngarkuar për çështje evropiane, Nikola Dimitrov.

Kryeministri Rama deklaroi se fokusi i takimit të sotëm ishte të njerëzit, kompanitë, fermerët, punëtorët, studentët, pra ata që janë përfitues të kësaj nisme.

Edhe Rama tha se afaristët njëzëri dhanë mbështetje për “Ballkanin e hapur”, mirëpo kërkuan që të zbatohen marrëveshjet politike, posaçërisht ato që kanë të bëjnë

me kalimin në kufij. “Afaristët eksportojnë fruta të freskëta, perime dhe qumësht - këto janë produkte që mund të qëndrojnë në kufi për ditë të tëra. Nuk është e mundur të arrihen në kufi të premten mbrëma dhe të prisni deri të hënën sepse qumështi do të bëhet kos”, ka deklaruar Rama.

Rama: Pavarësisht prej qëndrimit të BE-së, ne nuk heqim dorë

Rama tha se, po ashtu, është marrë qëndrim i përbashkët për BE-në. “E kuptojmë situatën në BE, por ata e bllokojnë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, mirëpo ne kemi theksuar se nuk heqim dorë nga përpjekjet tona për t’i ndërtuar vendet tona sipas standardeve të BE-së”, ka theksuar Rama.

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut me vite janë duke e pritur datën nga Brukseli për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE.

Zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Nikolla Dimitrov, deklaroi se situata në vendin e tij është mjaft komplekse, mirëpo nuk kanë mundësi të mos jenë të pranishëm në këtë takim: “Kjo iniciativë është e rëndësishme për zhvillimin e ekonomive tona dhe për të ardhmen në BE”.

Zoran Zaev nuk mori pjesë ashtu siç ishte planifikuar më parë sepse, ndërkohë, ka paralajmëruar dorëheqjen nga posti i kryeministrit për shkak të rezultati të dobët të partisë së tij në zgjedhjet lokale të 31 tetorit në Maqedoninë e Veriut.

I pyetur se a do të ta nxisë Kosovën që t’i bashkohet nismës, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se Beogradi i rregullon marrëdhëniet me Prishtinën nëpërmjet dialogut të Brukselit dhe se “Ballkani i hapur” është i hapur për të gjithë. “Ne ua kemi hapur derën edhe Prishtinës, edhe Sarajevës, edhe Podgoricës”, porositi Vuçiq.

Ndërkaq Rama theksoi se Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut po i ftojnë të gjithë në rajon t’i bashkohen “Ballkanit të hapur”. “Kur bëhet fjalë për mosmarrëveshjet, ne kemi një dialog që ka rrugën e vet. Nëse gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor bëhen pjesë e kësaj, do të jetë shumë më mirë si për Kosovën, ashtu edhe për Bosnje e Hercegovinën”, ka deklaruar Rama.

Ai tha, gjithashtu, se shqiptarët dhe serbët për Ballkanin janë njësoj si gjermanët dhe francezët për Evropën. Siç shpjegoi ai, pas Luftës së Dytë Botërore gjermanët dhe francezët filluan bashkëpunimin ekonomik dhe themeluan Komunitetin e Qymyrit dhe Çelikut nga i cili u



formua BE-ja.

Lidhur me këtë, Vuçiqi shtoi se serbët dhe shqiptarët do të grinden se kush do të jetë gjerman dhe kush francez. “Në kuptimin politik, kjo nismë është mënyra më e mirë për ta kapërcyer problemin”, tha Vuçiq. Kosova, Mali i Zi dhe Bosnje e Hercegovina deri tash nuk e kanë mbështetur këtë nismë. Gjatë takimit të së enjtes (4 nëntor) të udhëheqësve të nismës “Ballkani i hapur”, është mbajtur një takim me përfaqësuesit e organizatës joqeveritare “Atlantic Council” (Këshillit Atlantik). Sipas kryeministrit shqiptar, përfaqësuesit e këtij këshilli kanë ardhur nga Uashingtoni për ta mbështetur këtë nismë.

Çfarë është “Ballkani i hapur”?

Nisma për bashkëpunimin rajonal “Ballkani i hapur”, e cila përfshin Serbinë, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, është marrë nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kryeministri tashmë në dorëheqje i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në tetor të vitit 2019.

Nisma fillimisht është quajtur “Mini Schengen” dhe ajo parasheh lëvizjen e lirë të kapitalit, mallrave, shërbimeve dhe njerëzve midis tri vendeve. Në korrik të këtij viti, në Forumin për Bashkëpunim Ekonomik Rajonal në Shkup, nisma ka marrë emrin e ri, “Ballkani i hapur”.

Çfarë është arritur deri më tani?

Në kuadër të kësaj nisme është vendosur lëvizja e lirë e qytetarëve me letërnjoftim ndërmjet Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, është nënshkruar marrëveshja për bashkëpunim për parandalimin dhe eliminimin e pasojave të fatkeqësive natyrore. Po ashtu, janë nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim për lehtësimin e importit, eksportit dhe lëvizjes të mallrave në Ballkanin Perëndimor, si dhe një

memorandum mirëkuptimi dhe bashkëpunimi për qasje të lirë në tregun e punës. Ndërmjet Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë është rënë dakord që kontrollet kufitare të hiqen nga 1 janari i vitit 2023. Po ashtu, është planifikuar që gradualisht të krijohet një treg i përbashkët për 12 milionë banorë, aq sa kanë banorë këto tri shtete së bashku, pra të krijohet një “zonë e vetme ekonomike”.

A po humbet Kosova nga refuzimi i “Ballkanit të hapur”?

Në Prishtinë, profesori i Shkencave Ekonomike, Muhamet Mustafa, thotë se nisma “Ballkani i hapur” nuk mund të jetësohet përderisa Serbia ka qasje penguese për Kosovën, Malin e Zi dhe Bosnje e Hercegovinën. Duke qenë pjesë e nismave të tjera më të fuqishme, sipas profesorit Mustafa, Kosova nuk humbet asgjë nga refuzimi i “Ballkanit të hapur”. “Serbia, derisa promovon lëvizjen e lirë të mallrave, ajo shfaq pengesa të mëdha në tregtimin me Kosovën - po i pengon sportistët, nuk po sillt në bazë të marrëveshjeve të Brukselit dhe ka një seri pengesash që bën në tregti me Kosovën, por sigurisht edhe me vendet e tjera, sigurisht sepse ajo praktikon edhe një subvencionim të sektorëve të caktuar sikurse është industria e qumështit apo të tjerat, kështu që e deformon edhe tregtinë e lirë në rajon”, vlerëson ai.


Profesori Mustafa thotë se nisma “Ballkani i hapur” mund të shndërrohet në një nismë të izoluar që mund të mbetet me vetëm Shqipërinë, Serbinë dhe Maqedoninë Veriore si pjesëtare. Zgjidhja më e mirë për ta arritur hapjen e tregut në vendet e Ballkanit Perëndimor, sipas profesor Mustafës, është ai që njihet si Procesi i Berlinit e që është një nismë e udhëhequr nga Gjermania me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit rajonal në mes të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor, e që ka mision ndihmën ndaj

këtyre shteteve për përmbushjen e kriterëve për t’u anëtarësuar në BE. “Janë të mirëseardhura lehtësimi i tregtisë, evitimi i barrierave, tregtia e lirë, konkurrenca e lirë, por këto sigurohen nëpërmes procesit të Berlinit dhe ku ekziston një asistencë e vendeve më të fuqishme evropiane dhe në atë drejtim edhe relativizohen konfliktet politike dhe mund të arrihen rezultate më të mëdha”, shprehet profesor Mustafa.

Procesi i Berlinit, i nisur nga kancelarja gjermane Angela Merkel në vitin 2014, mes të tjerash, synonte që fillimisht të lidhte mes vete gjashtë vendet në fushat e transportit dhe energjisë, dhe më vonë kjo lidhje të zgjerohet edhe me shkëmbimin për rininë dhe bashkëpunimin ekonomik.

Qëndrimi zyrtar i Qeverisë së Kosovës për “Ballkanin e hapur” ka qenë se nga kjo nismë do të përfitonte vetëm Serbia dhe se përmes saj (nismës) i hapet rrugë ndikimit nga Rusia dhe Kina. “Ballkani i hapur” ngjan më shumë si Ballkan i hapur për ndikimet nga Lindja, sidomos nga Federata Ruse, por edhe nga Kina, si dhe Ballkan i hapur për autokracinë, për korrupsionin, për kriminelët e luftës...”, kishte deklaruar kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më 1 gusht 2021, pasi Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut vendosën ta ndryshonin emërtimin e iniciativës nga “Mini-Schengen” në “Ballkani i hapur”.

Kjo nismë përplasi edhe Kosovën me Shqipërinë. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, muajt e kaluar e ka kritikuar vazhdimisht Qeverinë e Kosovës, e cila, sipas tij, po merret me teori konspirative në vend që ta jetësojë bashkëpunimin. Por, për dallim prej qëndrimeve kundërshtuese në Kosovë për nismën “Ballkani i hapur”, në Shqipëri mendojnë se kjo do të ishte një mundësi e mirë për avancim të lirisë së lëvizjes, si dhe tregti pa pengesa në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Njohësi i ekonomisë nga Tirana, Fatos Cocoli, thotë se Kosova duhet ta përkrahë këtë iniciativë pavarësisht prej problemeve politike me Serbinë. (rel)



GJYKATA SPECIALE NJË VJET MË PARË KISHTE NGREHUR AKTAKUZËN PËR ISH-KRERËT E UÇK-SË

Një vjet padrejtësi ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së

Sot, më 5 nëntor, bëhet një vjet qëkur Dhomat e Specializuara në Hagë kanë konfirmuar aktakuzën ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Ndonëse është bërë një vjet që Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në paraburgim, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ende nuk ia ka dorëzuar mbrojtjes dosjen paraprake dhe nuk dihet se kur do të fillojë shqyrtimi kryesor i këtij procesi. Avokatët e ish-komandantëve të UÇK-së kanë vlerësuar se klientët e tyre po mbahen qëllimisht në paraburgim. Ata kanë bërë me dije se kjo gjykatë është ndërtuar mbi gënjeshtër dhe se procesi ndaj klientëve të tyre është i padrejtë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Sot (e premtën) bëhet një vjet kur ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë paraburgosur në Hagë pas konfirmimit të aktakuzës nga Gjykata Speciale. Më 5 nëntor të vitit të kaluar Dhomat e Specializuara kishin konfirmuar aktakuzën ndaj ish-krerëve të UÇK-së dhe ishin ftuar të paraqiten në gjykatë. Thaçi, Veseli dhe Selimi, pas marrjes së ftesës, vullnetarisht kishin udhëtuar për në Hagë. Në paraqitjen e tyre të parë para trupit gjykues, ata janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës për

krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Deri më tani janë mbajtur disa konferenca statutoire me qëllim të organizimit të shkëmbimeve ndërmjet palëve. Fillimisht në këto seanca ish-komandantëve të UÇK-së u është lexuar aktakuza, ku ata kanë hedhur poshtë pretendimet e prokurorisë.

Konferencat statutoire janë karakterizuar me përplasje të avokatëve me përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorisë së Specializuar. Pala mbrojtëse ka akuzuar vazhdimisht prokurorinë për zvarritje të qëllimshme të procesit dhe mosdorëzim të dosjes paraprake. Ndonëse është mbushur një vjet, prokuroria ende nuk ka caktuar ndonjë datë se kur mund ta dorëzojë

dosjen paraprake.

Vetëm në seancën e fundit statutoire, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) është urdhëruar që deri më 17 dhjetor të këtij viti ta dorëzojë dosjen paraprake në rastin ku Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë duke u akuzuar për krime lufte nga Gjykata Speciale.

Vendimi i gjyqtarit paraprak, Nicolas Guillou, është marrë pasi në konferencën e tetë mbi ecurinë e çështjes, të mbajtur më 29 tetor, prokuroria kishte deklaruar se pasi kanë shqyrtuar burimet që kanë, konfirmojnë se do të jenë në gjendje ta dorëzojnë dosjen paraprake në rastin e Hashim Thaçit e të tjerëve dhe materialet që lidhen me të më 17 dhjetor 2021.

**Avokatët mbrojtës:
Themelet e Speciales
janë të mbështetura në
gënjeshtër**

Akuzat më të ashpra të avokatëve ndaj kësaj gjykate janë thënë në seancën e fundit për ecurinë e çështjes, e cila është mbajtur të premtën e kaluar. Në këtë seancë avokatët e ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë thënë se themelet e gjykatës Speciale janë mbështetur mbi gënjeshtër. Ben Emmersoni, avokati mbrojtës i Kadri Veselit, ka thënë se kjo gjykatë është ndërtuar mbi një raport të rrejshëm të Dick Martit. Sipas tij, gjithë kjo vonesë po bëhet qëllimshëm që krerët e UÇK-së të mbahen në paraburgim. "Ky është një proces i qëllimshëm që këta burra të rrinë në paraburgim. Ne nuk e dimë se kur do të fillojnë hetimet e tyre. Institucioni u themelua për t'i shqyrtuar këto akuzat absurde të cilat ishin të rreme. E dimë që u sajuan nga dëshmitarë të cilët i ka paraqitur zbulimi i fshehtë serb. Prokuroria nuk ka gjetur asnjë provë mbështetëse për akuzat e saj. Themelet për

ngritjen e këtij tribunali kanë qenë të mbështetura në gënjeshtër. Dick Marty shkroi një raport që përfshinte akuzat më absurde për UÇK-në", ka thënë ai.

Emmersoni ka theksuar se ish-krerët e UÇK-së nuk kanë bërë asgjë, por vetëm kanë qenë politikanë të suksesshëm. Ai ka thënë se e sheh të pamundur që gjykimi ndaj komandantëve të UÇK-së të fillojë para fundvitit të vitit 2022. "Nuk mendoj, dhe duket absolutisht e pamundur që gjykimi të fillojë para fundvitit të 2022-s", ka thënë Emmersoni.

Akuzat ndaj Prokurorisë së Specializuar të Hagës i ka pasur edhe avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe. Ai e quajti "qesharake" qasjen e prokurorisë duke vënë në dukje se prokuroria në fillim pretendonte se gjykimi të niste në verën e këtij viti. "Është shokuese për mua pozicioni i ZPS-së. Jam i sigurt që edhe ju zoti gjykatës jeni mërzhitur nga kjo. Klientët tanë janë burgosur që nga viti i kaluar. Avokati koleg sapo na tha që afati fillestar ishte maji. E kuptoj zoti gjykatës që e keni shtyrë. Çfarë ka ndodhur? Që nga konferenca e parë ne kemi

Limaj kujton arrestimin e Jakup Krasniqit

Ndërkaq të enjten është bërë një vjet nga arrestimi i ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi nga Gjykata Speciale. Me këtë rast, lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se Jakup Krasniqi është duke u mbajtur padrejtësisht larg

familjes dhe atdheut. “Sot një vit nga privimi i lirisë që iu bë ish-zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Jakup Krasniqi, që vazhdon të mbahet padrejtësisht larg familjes e atdheut. Jakup Krasniqi gjithë jetën e tij ka qenë në shërbim të lirisë. Ai

ka qenë dhe mbetet udhërrëfyese se si duhet e punohet për atdheun. Ne qëndrojmë fort në mbështetje të fuqishme, me besim të palëkundur në pastërti dhe atdhetarizmin e bacës Jakup Krasniqi”, ka thënë Limaj.

marrë 1 732 dokumente tekta mbrëmë kemi marrë mbi 200 dokumente. Jam dakord me Robertsin. Kur do t'i vijë fundi kësaj çështjeje? Tani na kërkohet që afati të shtyhet deri më 31 janar. Flitej që gjykimi do të fillonte në këtë vit, teksa tani dëgjojmë këtë kërkesë për shtyrje. Klienti im është në burg. Kjo është qesharake. Duhet të ketë një pikë dalje. Ata kanë vendosur që t'i ndalojnë këta burra”, ka thënë avokati Keohe.

Edhe avokati i Rexhep Selimit ka kritikuar prokurorinë për zvarritjen e procesit të nxjerrës së materialeve. Ai ka thënë se sa më shumë që po afrohen te materialet aq më shumë po zgjatet procesi. “I nderuar

gjykatës, unë vetë nuk jam vrapues, por nga ana tjetër e shoh që sa më shumë të lëvizim ne aq më shumë na largohet pika e arritjes. Nga ana ime, pa u futur në detaje dhe në hollësi për materialet, mund të them se nuk kemi bërë asnjë lloj progresi. Jemi tërësisht në të njëjtin situatë dhe na u kërkua sërish që afati kohor të shtyhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm”, ka thënë avokati i Rexhep Selimit.

Apeli refuzon kërkesën e Thaçit, mbetet në paraburgim

Paneli i Gjykatës së Apelit, në kuadër të Gjykatës Speciale, ka

hedhur poshtë kërkesën e parashtruar nga Hashim Thaçi kundër vendimit të gjykatës të procedurës paraprake për mbajtjen e tij në paraburgim. Sipas Apelit, Thaçi ka dështuar të dëshmojë se pse vendimi paraprak ka qenë i paarsyeshëm për rreziqet nëse ai lirohet. Në vendimin e apelit thuhet se gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka pasur informacion të mjaftueshëm përpara tij në lidhje me kushtet e propozuara të lirimimit për t'i mundësuar atij të marrë një vendim të informuar për zbutjen e rreziqeve të identifikuar.

Ndërsa në fillim të tetorit Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi kanë fituar

betejën e parë në Dhomat e Specializuara. Paneli i Gjykatës së Apelit ka rrëzuar vendimin e nxjerrë nga gjyqtari i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, i cili ua kishte refuzuar lirimimin e parakohshëm nga paraburgimi.

Apeli ka kthyer çështjen në rivendosje, duke kërkuar më shumë bashkëpunim me Policinë e Kosovës për lirimimin e mundshëm të të akuzuarve. “Paneli kujton se kryerja e një hetimi të tillë do të binte në kompetencat diskrecionale të cilit i janë dhënë gjyqtarit të procedurës paraprake në përputhje me nenin 39 (13) të ligjit në lidhje me çështjet e lidhura me paraburgimin, varësisht prej rrethanave të rastit. Paneli gjithashtu vëren se gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka dhënë arsye për të mos urdhëruar drejtorin e policisë që të japë një përgjigje të hollësishme pavarësisht se e pranon nevojën për të”, është thënë në vendim.

Për çfarë akuzohen ish-krrerët e UÇK-së?

Ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreut të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-

anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep Selimi dhe ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, rëndojnë akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Sipas aktakuzës, Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi dyshohen për veprat penale që kanë të bëjnë me krime lufte: ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe krime kundër njerëzimit: burgosje, akte të tjera çnjerëzore, zhdukje me forcë të personave dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit 1999.

Krimet pretendohet se janë kryer në disa lokacione të Kosovës dhe në veri të Shqipërisë, përkatësisht në Kukës dhe Cahan. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Këto krime të pretenduara përmenden në një raport të Këshillit të Evropës, të vitit 2011, autor i të cilit është senatori zviceran, Dick Marty.

BE-ja përsërit: Kosova t'i zbatojë marrëveshjet



PRISHTINË, 4 NËNTOR - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka thënë se institucionet evropiane presin që Kosova dhe Serbia t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

I pyetur nga gazetarët ta komentojnë deklaratën e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, i cili ka thënë për “BBC”-

në se nuk do ta lejojë formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, Stano ka thënë se “në parim nuk i komenton deklaratat e palëve të treta”. “Qëndrimi ynë është shumë i qartë për marrëveshjet e arritura në dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Ne duhet ta respektojmë marrëveshjen dhe të bëjmë çmos për ta siguruar zbatimin e atyre

marrëveshjeve”, ka thënë Stano. Në një intervistë për “BBC”-në, Kurti ka thënë se me krijimin e asociacionit do të krijohet “diçka e ngjashme me Republikën Sërpska në Kosovë”, andaj nuk do të lejojë që “në Kosovë të përsëritet Bosnja”. Republika Sërpska, e banuar me shumicë serbe, është një nga dy entitetet që përbëjnë Bosnje e Hercegovinën. Entiteti tjetër është Federata

Myslimane-Kroate. Kosova dhe Serbia, nën ndërmjetësimin e BE-së, kanë arritur marrëveshje për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në vitin 2013. Dy vjet më vonë dy vendet kanë arritur edhe një marrëveshje shtesë për themelimin e tij, por Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se parimet për të nuk janë në përputhje me

Kushtetutën e Kosovës, edhe pse ka thënë se ato mund të harmonizohen me një akt ligjor të Qeverisë së Kosovës. Pala serbe këmbëngul që Kosova duhet ta zbatojë marrëveshjen për Asociacionin. BE-ja, në disa rase, ka bërë thirrje për zbatimin e marrëveshjes. Kurti, edhe më herët, ka thënë se në Kosovë “nuk mund të ketë asociacion njëetnik”.

HASHIM THAÇI, I MUNGUARI I MADH I KOSOVËS

(Në njëvjetorin e burgosjes së presidentit)



Shkruan: Ismail SYLA

1. "Ta burgosësh një njeri të lindur në ditën e pranverës është krim i madh", më tha në një rast presidenti Hashim Thaçi. "Është ditë e bekuar!" Kur e tha këtë, nuk ishte dita e ditëlindjes sime, 21 marsi, që si ngjarje jetësore i bën miqtë e mi dhe të tjerët të shprehin urime nga më të përzemërtat, por edhe aso stereotipa e konvencionale. Jo. Duke qenë afër tij për dy dekada, dita e parë e fillimit të pranverës i ishte ngulitur në kujtesë edhe si ditëlindja ime. Kjo më bëri me dije se në "procesorin" e mendjes së tij zënë vend edhe datat, por edhe vlerësimet e mirëmenduar. Ky formulim për mua e mori vlerën e një perle. Ishte vlerësimi më lirik i mundshëm, nëse brenda shprehjes lirizëm ndërthehet dashamirësia, njerëzshmëria dhe konsiderata me shpërfaqje më të lartë estetike. Ishte një nderim për një ish të burgosur politik të dënuar në moshë të re nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës më 12 korrik 1982. Ishte konsideratë për plejada të tëra ish të burgosurish politikë. Vëllai i tij i madh, Ganiu ishte burgosur në vitin 1981. Pra, që në fëmijëri Hashim Thaçi e kishte të integruar natyrshëm respektin për këtë kategori njerëzish.

2. Vizita e parë e Hashim Thaçit në shtëpinë tonë në Kizharekë ishte për qejf. Si çdo njeri që ka rastin ta pres në konak një personalitet të lartë kombëtar, me përgjegjësi politike dhe institucionale edhe unë u ndjeva shumë i nderuar. Ishte vizita e kryeministrit të Republikës së Kosovës. Por, domethënia më kuptimplote dhe më e fuqishme për këtë vizitë u formulua nga vetë ai. "Pata dëshirë ta vizitoj shtëpinë tuaj, sepse kjo shtëpi dhe ky truall është bastisur shpesh nga UDB-ja." Ai e kishte të qartë historinë e familjes sonë, e cila ishte në shënjestër të pushtetit jugosllav qysh nga viti 1972, kur vëllai im i madh, Gani Sylaj i kishte dhënë gati përbotshëm të gjitha shenjat se në këtë botë Kosova kishte një armik të madh, Jugosllavinë. Historia ka ndërruar përfundimisht. Shtëpinë dhe truallin tonë tashmë e nderojnë personalitetet më të larta kombëtare të Kosovës së lirë, themelues të shtetit tonë të ri.

3. Si kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, Hashim Thaçi nuk ishte nga ata që i kanë strikte ardhje - daljet në zyrë. As ndonjë imponim të disiplinës "ushtarake", kushtimisht ta themi. Sapo makina e tij hynte në parkun e

selisë së PDK-së, gjithçka bëhej serioze, që nga djemtë e sigurimit të objektit, shkallët që çonin deri te zyra, duke kaluar nëpër ato të Odës Ekonomike. Pra një hije e rëndë serioziteti vihej vetvetiu në hapësirat e PDK-së. Më vonë Arianit Bytyçi, shef i zyrës së informimit në Kryeministri, që i përcillte rregullisht mbledhjet e Qeverisë, kishte vërejtur se kur mungonte në raste të rralla ose nuk ishte i pranishëm përkohësisht kryeministri Thaçi, ministrat ishin më të shpenguar. Sapo ai kthehej, shpengimi mblidhej dhe rrjedhës së mbledhjeve i kthehej hija e rëndë, pra pesha dhe rrezatimi i liderit me premisa pothuajse të lindura, por të kultivuara përgjatë sprovave jetësore.

4. Në rreth të ngushtë shoqëror nga Hashim Thaçi dilte në pah një natyrë e butë prej njeriu. Anëtarë kryesie, shefa deputetësh dhe miq të tij dinin të ishin të zëshëm, polemizues, të ngutshëm për të shfaqur mendime, analiza dhe vlerësime. Në këtë atmosferë debati, kur ai donte të ndërhynte, nuk ia jepnin rastin. Ishte diçka e kundërt me atë hijen e rëndë të hapësirës në selinë e PDK-së ose në mbledhjet e qeverisë. Por, kuptohet, mjedisi ishte miqësor. Dhe për ta bërë

atmosferën efektivisht më shpirtërore, në një rast u tha miqve - bashkëpunëtorë: - Shyqyr që jam kryetar, se nuk ma kishit dhënë fjalën asnjëherë!... Pastaj plasën të qeshurat.

5. Si strateg politik, Hashim Thaçi, si të thuhet, investonte energji përreth dhe përtej dy komunave të Drenicës, bazë tradicionale e PDK-së. Përpos përkushtimit në Prizren, - metaforikisht Jerusalemit të PDK-së, pika të dobëta i kishte Rahovecin dhe Malishevën. Kush i mernte ato dy komuna, i afrohej Drenicës. Për shkak të përçarjeve të politikanëve dhe komandantëve të Malishevës, në zgjedhjet e para komunale pas luftës nuk arriti të fitojë PDK-ja. E, në zgjedhjet e radhës kryetari Thaçi arriti t'i bashkojë të gjithë krerët e fraksioneve në shtëpinë e një familjeje të nderuar në Malishevë. Secilit "lider" lokal ia kishte sjellë përfaqësuesin përkatës nga qendra. Komandantit lokal një komandant të qendrës, ish të burgosurit politik me influencë lokale një ish të burgosur me nam. Atë mbrëmje u arrit pajtueshmëria efektive. Ishte koha kur energjia elektrike ndërpritej dhe ndonjë agregat nuk soste edhe aq mirë punë. Kur filloi shpërndarja e njerëzve, njëri prej aktorëve që pranoi konsensusin tha se nuk po i gjente këpucët e tij. Kryetari Thaçi i tha me humor: - Mbathi cilat të mundesh. Tani jeni një. Shpërthyen të qeshurat... Pas pak ditësh PDK-ja fitoi në Malishevë.

6. Me rastin e hartimit të biografisë së kryeministrit Hashim Thaçi për web faqen zyrtare, kishim parë modelet më të mira të zyrtarëve të lartë euroatlantikë. Paragrafët nisnin me funksionin ose pozitën aktuale, më të lartën, për t'u renditur për së prapthi, deri te shkollimi fillestar. Kështu, bie fjala përmbajtja e paragrafit të parë thoshte: Pas fitores së PDK-së në zgjedhjet parlamentare të 17 nëntorit 2007, z. Hashim Thaçi u zgjodh kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës me 9 janar 2008. Ndërkaq, në paragrafin vijues thuhej: Më 17 shkurt 2008, në Kuvendin e Kosovës kryeministri Hashim Thaçi e shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Biografia për një kohë të gjatë mbeti në tavolinën e kryeministrit.

Mendja na shkonte te ndonjë pakënaqësi e tij rreth paragrafëve. Kaloj një kohë pa u publikuar kjo biografi në faqen zyrtare të kryeministrit. Më në fund erdhi momenti. Kryeministri Thaçi e kishte "lekturuar" tekstin. Nuk kishte asnjë vërejtje esenciale. E vetmja vërejtje dhe pengesë për vonim ishte bërë një shkronjë, një zanore "e", një nyje para foljes "shpalli". Mua sikur m'u ndriçua rëndësia e korrigjimit. Formulimi me zanoren - e shpalli, sikur e vononte paksa procesin e shpalljes së Kosovës shtet i pavarur. Në akt i prituri dymijë vjet nuk bënte të vonohej, të ngatërrohej të ngecte në një prag-pengesë prej një tingulli zanor. Pra, sa më shpejt e shkurt duhej shkruar "shpalli Kosovën shtet të pavarur..."

7. Më 5 nëntor bëhen një vit nga paraburgimi i Presidentit Hashim Thaçi. Nga gazetarja e RTK-së, Elmina Osmani më erdhi një sms në telefon: "Jemi duke punuar disa reportazhe tash në prag të një vjetorit të shuarjes në Hagë të krerëve të UÇK-së. Kishte me qenë nder me ju pasur ju në një rrëfim për Presidentin Thaçi. Reportazhi ka të bëjë me kujtime emocionuese, pa hyrë në ato çka ka të bëjë Gjykata Speciale. Mbesim me shpresë se do të na përgjigjeni për këtë kërkesë." Gazetaren Osmani e falënderoj shumë për ftesën. Ky shkrim që kërcen nga një motiv në tjetrin pothuajse i përgjigjet kërkesës së gazetares së RTK-së. Nga disa paraqitje në studio televizive e kam vërejtur se fytyrën time nuk po e duron ekрани. Ndoshta çështje moshe. Aq më tepër se një moshatar imi, i nderuari profesor Enver Hasani paska thënë se Ismaili është i mirë kur shkruan, por jo kur flet. Unë nuk po sugjeroj asgjë për pamjen as shkrimet e tij, por do ta respektoj këshillën e z. Hasani, 60 vjeçar.

8. Në fund një përshtypje nga vizita që i bëra Presidentit Thaçi në Hagë, para dhjetë ditësh Ai ishte në gjendje jashtëzakonisht të mirë shëndetësore. Vital. Po merrej me të gjitha aktivitetet sportive të mundshme. Me përpikëri spartane e ruan higjienën mentale dhe si ditën që na tha "lamtumirë" përkohësisht, do të thotë "mirës se u gjeta" së shpejti, me shëndetin, bukurinë dhe rrezatimin e tij presidencial.

Prishtinë, 4 nëntor 2021

Vaksinimi në Kosovë mund të bëhet pa termin

Ministria e Shëndetësisë i ka informuar qytetarët se duke filluar nga dita e premte ata mund të vaksinohen në cilëndo qendër të vaksinimit në Kosovë, pa termin të caktuar paraprakisht

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se nga e premte qytetarët mund të vaksinohen në cilëndo qendër të vaksinimit në Kosovë, pa termin të caktuar paraprakisht. "Qytetarët mund të vaksinohen në secilën qendër të vaksinimit kudo në Kosovë, pavarësisht se cilës komunë i takojnë me vendbanim.

Ministria e Shëndetësisë vlerëson se tashmë një numër i konsideruar i qytetarëve të grupmoshave të ndryshme janë vaksinuar kundër Covid-19 dhe kjo e bën edhe më të lehtë menaxhimin e procesit të vaksinimit në çdo qendër, ku përmes ekipeve të vaksinimit në dispozicion, ka kapacitete për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave të qytetarëve për vaksinim", ka njoftuar MSh-ja. Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë rikujton se këtyre ditëve është duke u bërë vaksinimi edhe përmes ekipeve mobile. "MSh u bënë thirrje qytetarëve që ta kompletojnë procesin e vaksinimit duke i marrë të dyja dozat e vaksinës kundër Covid-19. Në Kosovë vaksinimi kundër Covid-19 është i lejuar për të gjithë

qytetarët nga mosha 12 vjeçe e lart. Në këtë kohë kur në shtete të ndryshme të Evropës, por edhe në rajon, po regjistrohen shifra shumë të larta të infektiveve me Covid-19, me variantin 'Delta', vaksinimi i popullatës mbetet rruga më e sigurt për ta mbajtur situatën e qetë epidemiologjike në vendin tonë dhe për ta arritur imunitetin kolektiv", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.

Kjo ministri ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë dhënë 2 748 doza të vaksinës kundër Covid-19. "Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 575 375 doza të vaksinës. Deri më sot 735 357 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", është theksuar në njoftimin për media.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, nga 1 707 testime, 14 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. "Sot janë shëruar 16 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 402. Në total numri i rasteve aktive është 443", ka njoftuar MSh-ja.



Tolaj: Disa nga masat janë totalisht të paarsyeshme

Infektologu Ilir Tolaj ka thënë se Kosova është në një situatë jashtëzakonisht të volitshme dhe stabile epidemiologjike. "Është jashtëzakonisht e rëndësishme është që ta mbajmë situatën nën kontroll. Në të njëjtën kohë të vazhdojmë vaksinimin në mënyrë masive, duke përfshirë edhe fëmijët dhe duke e paramenduar edhe dozën e tretë në të ardhmen,

në mënyrë që sa më shumë popullata të jetë e mbrojtur", ka thënë Tolaj në emisionin "Ora shtatë" të "Klan Kosovës". Infektologu Tolaj ka thënë se lirimi i pakontrolluar i masave para pushimeve verore e solli valën e pandemisë në Kosovë më herët sesa në vendet e tjera. Ai ka shpjeguar se, pavarësisht prej masave që merren, pandemia është e pamundur të kontrollohet në

tërësi derisa populli nuk ka një nivel mbrojtës. Tolaj ka theksuar se disa nga masat janë totalisht të paarsyeshme. "Disa nga masat janë totalisht të paarsyeshme si, për shembull, mbajtja e maskave në ambiente të hapura nuk ka ndonjë logjikë aspak, kur në një ambient të mbyllur të gjithë i heqin ato maska. Ose ora policore nuk ka asnjë sens", është shprehur Tolaj.

Kërkohet paraburgim ndaj pesë të pandehurve për falsifikim të parave

PRIZREN, 4 NËNTOR - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve B. B., T. P., V. Z., L. E. dhe A. P. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se kanë kryer veprën penale "Falsifikimi i parasë" nga neni 296 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). "Sipas kërkesës, i pandehuri B. B. gjatë muajit tetor deri në fillim të muajit nëntor të vitit 2021, në kohë të pavërtetuar, në Prizren është vërtetuar se i njëjti me dashje ka para të falsifikuara me qëllim të vënies në qarkullim të tyre si të vërteta, në atë mënyrë që përgjatë periudhës së lartpërmendur i shet të pandehurit T. P. 1 250.00 euro, të gjitha në monedha metalike nga 2 dy euro, me qëllim që ky i fundit t'i vë të njëjtat në qarkullim si të vërteta, me ç'rast i pandehuri T. P. pajtohet që t'i blejë të njëjtat për shumën e



parave prej 900.00 euro duke i paguar në mënyra periodike,

ashtu që herën e parë për 300.00 euro false paguan 200.00 euro

originale, ndërsa herën e dytë për 400.00 euro false paguan

300.00 euro origjinale, derisa në herën e tretë për 550.00 euro false paguan 400.00 euro origjinale. Në total i pandehuri B. B. arrin t'i shesë 1 250.00 euro false. Në këtë mënyrë B. B. ka kryer veprën penale 'Falsifikimi i parasë' nga neni 296, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)", ka njoftuar Prokuroria Themelore Prizren.

Sipas këtij njoftimi, të pandehurit T. P., V. Z., L. E. dhe A. P. gjatë periudhës së muajit tetor deri në fillim të muajit nëntor të vitit 2021, në intervale të ndryshme kohore, me dashje dhe në bashkëkryerje është vërtetuar se kanë vënë në qarkullim paratë e falsifikuara si të vërteta.

Të pandehurit e lartcekur, me vendim të prokurorit të shtetit, gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh dhe për ta Prokuroria Themelore në Prizren do t'i vazhdojë veprimet e tjera hetimore.

Shtohen ankesat e konsumatorëve për ngritjen e çmimeve

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) të enjten ka mbajtur tryezën e diskutimit "Ngritja e çmimeve në treg dhe mbrojtja e konsumatorit".

Dardan Abazi nga INDEP në fjalën hyrëse gjatë kësaj tryeze ka thënë se përmes programit të tyre "Mbrojtja e konsumatorit"

kanë dhënë një kontribut tejet të rëndësishëm mbi mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.

Abazi ka theksuar se ankesat e konsumatorëve janë të shumta për rritje të çmimeve të paparalajmëruar nga tregtarët, siç është shprehur ai, në disa raste ka edhe dyshime për shtrenjtime me marrëveshje. "Instituti INDEP e ka futur në programin e vet mbrojtjen e konsumatorëve, duke dhënë

politika se si mund të ketë ndryshime duke shprehur që qeveria ta sjellë draftin e parë për mbrojtjen e konsumatorëve. Me kontributin tonë kemi përmirësuar këtë koncept deri në fazën e fundit, ku përgjatë dy vjetëve ka mijëra qytetarë që janë pjesë e këtij komuniteti duke e shndërruar në një pikë reference për brengat e tyre", ka thënë ai. Zef Dedaj, zëvendësudhëheqës i Departamentit të Tregtisë në

Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka deklaruar se rritja e çmimeve vjen nga importimi nga vendet ndërkombëtare. Dedaj ka thënë se që nga janari kanë marrë 19 ankesa nga konsumatorët, prej tyre katër për ngritjen e çmimeve. Sakip Imer, drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kosovë të Konkurrencës, ka thënë se ata mund të intervenojnë vetëm atëherë kur shtrembërohet

konkurrenca e drejtë në treg. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se çështja e trajtimit të konsumatorëve do të duhej të ishte në fokus jo vetëm tash që ka ngritje të çmimeve të produkteve.

Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve, ka theksuar se krejt kjo situatë dhe ngritje e çmimeve është pa strategji.



Aprovimi i pjesshëm i ankesave në OShP dëmtoi buxhetin e Kosovës mbi 246 mijë euro

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Buxheti i Kosovës është dëmtuar për 246 mijë e 882 euro nga aprovimi pjesërisht gabim i 104 ankesave nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) për vitin 2020 dhe tremujorin e parë të vitit 2021. Kështu u tha në një konferencë për media të organizuar nga "Demokracia Plus" me rastin e prezantimit të raportit të monitorimit të OSHP-së. Ndërkohë u tha se me këtë rast aprovimi i pjesshëm i ankesës vetëm që të mos konfiskohet tarifa e ankesës, nxitë kompanitë që të dorëzojnë



ankesa të pabaza dhe njëkohësisht rrit numrin e ankesave.

Drejtori i Programit të

"Demokracia Plus", Albert Krasniqi, ka thënë se shpreson që bordi i ri i OSHP-së do t'i marrë parasysh të gjeturat e

këtij raporti, derisa ka shprehur gatishmërinë për ta mbështetur avancimin e OSHP-së.

Drejtoresha e programit në USAID "Komunat transparente, efektive dhe llogaridhënese", Afërdita Mekuli, ka thënë se për pesë vjet kanë parë se Organi Shqyrtues i Prokurimit është dukshëm më transparent.

Të gjeturat e raportit i ka paraqitur Agon Hysaj nga D+, i cili ka thënë se ankesat në OSHP zakonisht janë për tenderë me vlera të mëdha. Ai ka thënë se shumë investime kapitale të rëndësishme shtyhen për muaj

si pasojë e ankesave.

Këtë fat, siç ka thënë ai, e patën edhe nxënësit e Prishtinës, të cilët janë dëmtuar nga pamundësia e komunës për ta nënshkruar kontratën për pajisje të teknologjisë informative. Kurse me këto të gjetura u pajtua plotësisht kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Ardian Behra. "Nuk kam çka të shtoj as pikë, as presje në këtë raport, pajtohem plotësisht. Po shpresojmë që bordi i ri t'i marrë parasysh ato", ka thënë ai.

Qeveria gjermane do ta mbështesë projektin "Solar 4 Kosova"

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Në takim me kryeministrin Albin Kurti, bashkë me Volker Oel, udhëheqës i Drejtorisë të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ), u bisedua për rëndësinë e impiantit të parë për trajtimin e ujërave të ndotura urbane, i inauguruar në Prizren. Në njoftimin e zyrës së kryeministrin thuhet se në

këtë takim u tha se ky projekt i mbështetur nga shteti gjerman, Qeveria e Kosovës dhe komuna e Prizrenit do t'i lehtësojë sfidat në rritje e sipër, që lidhen me mungesën e ujit në vend. Kurti ka theksuar se, krahas stabilitetit institucional, Kosova ka një rritje ekonomike të paprecedentë. Oel ka shprehur mbështetje për qasjen e qeverisë kundër korrupsionit dhe luftimit të


krimit të organizuar, por edhe politikën për të ofruar perspektivë për të rinjtë e Kosovës.

Tema të tjera të cilat u biseduan në këtë takim janë ajo për Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve (ITP) në Prizren, për potencialin e migrimit qarkor për të sjellë njerëz dhe mundësi të mëdha për zhvillimin e Kosovës si dhe për tranzicionin energjetik,



përfaqësuesit e qeverisë gjermane mbështetjen për projektin "Solar 4 Kosova".

Çfarë quhet një 'mrekulli'? Ja si vendos Kisha Katolike



Nga Dorian LLYWELYN

Albino Luçiano, i njohur më mirë si Papa Gjon Pali I, mbretëroi si papë vetëm 34 ditë, përpara vdekjes së tij të papritur në shtatorin e vitit 1978. Por së shpejti ai do t'i bashkohet listës të papëve të shekullit XX-të, të cilët janë shenjtëruar (kanonizuar) nga Kisha Katolike. Kjo do të thotë se ata janë futur në listën e njerëzve të deklaruar zyrtarisht si pjesëtarë të Parajsës, dhe u është dhënë titulli "Të Bekuar" ose "Shenjtore". Procesi kërkon në vetvete një shqyrtim rigoroz të jetës dhe shenjtërisë së një kandidati, dhe përfshin disa faza që mund të zgjasin vite apo edhe shekuj. Pasi vdes një njeri me reputacion të jashtëzakonshëm, një peshkop mund të hapë një nisë një investigim mbi jetën e tij. Në këtë fazë, personit mund t'i jepet titulli "Shërbëtor i Zotit". Ndërkaq kërkohen detaje dhe kryhen hetime të mëtejshme, në mënyrë që ata të njihen si "të lumturuar", që është faza tjetër e kanonizimit. Hapi i mëtejshëm është lumturimi, kur dikush shpallet "i bekuar". Kjo zakonisht kërkon konfirmimi e Vatikanit, se personi bëri një "mrekulli" me ndërmjetësimin e Zotit. Duhet të paktën 2 mrekulli, përpara se një "i lumturuar" të shpallet

shenjtore. Në procesin e kanonizimit, një mrekulli i referohet thajse gjithmonë shërimit spontan dhe të qëndrueshë nga një gjendjeje shëndetësore e rëndë dhe kërcënuese për jetën. Shërimi duhet që të ketë ndodhur në mënyra që nuk mund të shpjegohen as nga njohuritë shkencore më të përparuara të kohës së sotme, dhe që pasojnë lutjet e personit në fjalë ndaj Zotit. Kështu lumturimi i Papa Gjon Palit I mori dritën jeshile nga shërimi i papritur i një vajze 11-vjeçare në Buenos Aires të Argjentinës, e cila vuante nga inflamacioni i rëndë akut i trurit, epilepsisë së formës më të rëndë dhe shoku septik. Ajo i ishte afruar asaj që mjekët e konsideronin si vdekja gati e sigurt në vitin 2011, kur nëna e saj, stafi infermior dhe një prift, filluan t'i luteshin me dëshpërim ish-papës. Besimi katolik te mrekullitë, është i kahershëm dhe i rrënjësor tek ata që besojnë tek Kisha, ashtuedhe tek jeta dhe vepra e Jezusit të Nazaretit. Ungjijtë e portretizojnë Jezusin si mësues, por edhe si një mrekullibërës, që në një rast e ktheu ujin në verë, eci mbi ujë, dhe ushqeu një turmë të madhe me një sasi minimale ushqimesh. Por në traditën katolike, mrekullitë

përfaqësojnë më shumë sesa shërimin fizik të dikujt. Ato konfirmojnë atë që predikoi Jezusi: që Perëndia është i gatshëm të ndërhyjë në jetën e njerëzve, dhe mund t'i çlirojë ata nga vuajtjet. Për të krishterët, mrekullitë e Jezusit sugjerojnë fuqishëm se ai është Biri i Perëndisë. Ato tregojnë atë që Jezusi e quajti "Mbretëria e Zotit", në të cilën të krishterët shpresojnë të ribashkohen me Perëndinë në një botë të rikthyer në përsosmërinë e saj origjinale. Natyrisht, shumë njerëz mund ta kundërshtojnë origjinën e pretenduar mbinatyrore të ngjarjeve të tilla. Dhe zhvillimi i shkencës mjekësore, nënkupton se disa procese shërimi mund të shpjegohen në fakt si një punë e natyrës, pa pasur nevojë të pretendohet se ka qenë në veprim ndërhyrja hyjnore. Disa shkrimtarë të krishterë, dhe veçanërisht teologu protestant Rudolf Bultman, i kanë interpretuar mrekullitë e Jezusit si të një kuptimi thjesht simbolik. Kisha Katolike ka pretenduar prej shekujsh se shkenca dhe besimi nuk janë armiq të betuar, por mënyra të ndryshme për të përvetësuar dije, dh që e plotësojnë njëra-tjetrën. Ky koncept udhëheq edhe investigimet e mrekullive të supozuara, të cilat kryhen nga

Kongregacioni i Vatikanit për Çështjet e Shenjtorëve, që ka një staf prej mbi 20 ekspertësh, dhe më shumë se 100 klerikë dhe këshilltarë. Teologët që punojnë në këtë Kongregacion, vlerësojnë të gjitha aspektet e jetës së një kandidati për t'u shenjtëruar. Këtu përfshihen edhe "Nxitësit e Besimit" (të quajtur nganjëherë "Avokat i Djallit"), roli i të cilit ndryshoi në vitin 1983 nga gjetja e argumenteve kundër kanonizimit, në mbikëqyrjen e procesit. Pastaj është edhe një bord ekspertësh të pavarur shkencorë, që hetojnë mbi një mrekulli të pretenduar. Ata e fillojnë punën duke kërkuar shpjegime thjesht natyrore, ndërsa rishikojnë historinë mjekësore të personit të shëruar. Procesi i kanonizimit ka pësuar rishikime të vazhdueshme gjatë historisë. Në vitin 2016, Papa Françesku nisi një reformim të mënyrës se si Kisha Katolike i vlerëson mrekullitë, të cilat synojnë ta bëjnë procesin sa më rigoroz dhe më transparent. Grupet katolike që kërkojnë hapjen e një procesi kanonizimi për një person të caktuar, janë edhe ato që e financojnë hetimin. Këtu përfshihen kostot si pagesat për ekspertët mjekësorë, shpenzimet administrative dhe kërkimin. Por disa raste që kanë qenë të

mjegullta, ishin edhe shumë të kushtueshme, duke arritur deri në qindra mijëra dollarë, shkruan gazetari italian Xhianluixhi Nuci në një libër të shkruar në vitin 2015. Një ndër reformat e Françeskut, ishte rregull i ri, sipas të cilit të gjitha pagesat do të kryhen me transfertat bankare të gjurmueshme, në mënyrë që grupet të mund të gjurmonin më mirë shpenzimet e Vatikanit. Po ashtu, që një rast kanonizimi të shkojë përpara, duhet që të paktën 2/3 e bordit mjekësor të pohojnë se ngjarja e mrekullueshme, nuk mund të shpjegohet ngashkaqe natyrore. Më parë, nevojitej vetëm një shumicë e thjeshtë. Synimi i përgjithshëm i këtyre reformave, është mbrojtja e integritetit të procesit të kanonizimit, dhe shmangia e gabimeve apo skandaleve, që do ta diskreditonin Kishën Katolike apo do të mashtronin besimtarët. Meqë katolikët besojnë se "të bekuarit" dhe shenjtoret janë në Parajsë, dhe ndërmjetësojnë tek Zoti në emër të njerëzve që kërkojnë ndihmën e tyre, çështja e mrekullive është çështje e të qenit të sigurt, se lutjet mund dhe do të dëgjohen. / "The Conversation" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

'Dardanët' do të përballen me Norvegjinë dhe Danimarkën

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Kosova do të ketë dy ndeshje shumë të rëndësishme në fund të muajit nëntor. "Dardanët" do të përballen me Norvegjinë në udhëtim më 25 nëntor nga ora 19:00, ndërsa më 28 nëntor e presim në shtëpi Danimarkën. Sfida do të zhvillohet nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Takimet zhvillohen në kuadër të parakualifikimeve për Euro Basket 2025. Ditë më parë përzgjedhësi i

Kosovës, Christos Marmarinos, ka shpallur listën e gjerë me 17 basketbollistë por, për shkak të rregullave nga FIBA, nuk do të ketë grumbullim dhe 12-shja përfundimtare do të shpallet më 20 nëntor, kurse më 22 nëntor do të udhëtojnë drejt Norvegjisë. Basketbollistët më 26 dhe 27 nëntor do të stërviten në Prishtinë, kurse më 28 nëntor do të përballen me Danimarkën. Numri i kombëtareve

pjesëmarrëse në parakualifikime të "Euro 2025" është dhjetë, ku një grup përbëhet nga katër kombëtare, kurse dy grupe të tjera me nga tri kombëtare. Katër skuadra, tre fituesit e grupeve, dhe një kombëtare e cila është e renditur në pozitën e dytë, më së miri do të kualifikohen për raundin e dytë parakualifikues. Raundi i dytë do të mbahet midis gushtit 2022, nëntorit 2022, shkurtit 2023.



Projekti i katapultave GPS, në shërbim të rritjes së cilësisë së klubeve dhe të ligës

"Ky projekt ka për qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për punë në klubet tona dhe shërben për rritjen e performancës individuale dhe ekipore. Po ashtu, nëpërmjet këtij programi do të kemi mundësi ta rritim edhe nivelin dhe radhitjen në listë, pasi edhe ashtu mendoj se jemi në një nivel më të lartë sesa që aktualisht jemi të radhitur në nivel evropian dhe botëror", ka thënë Agim Ademi, kryetar i FFK-së

PRISHTINË, 4 NËNTOR - FC Prishtina dhe Ulpiana janë dy klubet e tjera të BKT Superligës që janë pajisur të enjten në paketë të katapultave GPS të prodhuesit "Fitogther", në kuadër të fazës të projektit të digjitalizimit të klubeve. Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, në shoqëri të anëtarit të KE-së, Ismajl Ajetit, e kanë vizituar klubin bardhekaltër të kryeqytetit në fushën stërvitore në Bërnice si dhe klubin e Ulpianës në stadiumin "Sami

Kelmendi" në Lipjan, me ç'rast para futbollistëve dhe shtabit teknik të dy skuadrave janë shpalosur hollësitë e projektit të digjitalizimit të klubeve. Ademi në të dyja vizitat foli për rëndësinë e katapultave GPS në futbollin e sotëm modern dhe u shpreh i lumtur që FFK-ja po arrin t'i ndihmojë klubet në këtë aspekt. "Ky projekt ka për qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për punë në klubet tona dhe shërben për rritjen e performancës individuale, por edhe ekipore. Po



ashtu, nëpërmjet këtij programi do të kemi mundësi ta rritim edhe nivelin dhe radhitjen e ligës sonë në listë, pasi edhe ashtu mendoj se jemi në një nivel më të lartë sesa që aktualisht jemi të radhitur në nivel evropian dhe botëror", ka thënë Ademi. Kryetrajneri i Prishtinës, Zekirija Ramadani, e ka mirëpritur këtë

projekt dhe e ka falënderuar FFK-në që po i ndihmon klubet edhe në forma të këtylla me teknologjinë e kohës moderne. "Kjo është një ndihmesë shumë e madhe për ne. Jam i bindur dhe jua japë fjalën se do t'i shfrytëzojmë në mënyrën më të mirë këto katapulta, jo vetëm për ta ngritur nivelin tonë si skuadër,

por edhe në interes të rritjes së nivelit të futbollit të Kosovës në përgjithësi", është shprehur Ramadani. Ndërkaq drejtori sportiv i Ulpianës, Enver Duriqi, ka lavdëruar punën dhe kontributin e presidentit Ademi për përmirësimin e imazhit dhe organizimit të futbollit të Kosovës. "Dikur për dikë ka qenë ëndërr dhe iluzion të mendohet sistemi VAR, por ne sot po e implementojmë në futbollin tonë falë vizionit dhe vendosmërisë së presidentit Ademi. Projektet e FFK-së kanë qenë të vazhdueshme si për përmirësimin e infrastrukturës, po ashtu edhe për digjitalizim, prandaj jam i bindur se edhe donacioni i katapultave GPS nuk do të jetë i fundit, por vetëm vazhdimësi e strategjisë për ngritjen e mëtejme të futbollit të Kosovës", ka thënë Duriqi.

Federata e Kajakimit e Kosovës bëhet anëtare me të drejta të plota në Federatën Ndërkombëtare të Kajakimit



PRISHTINË, 4 NËNTOR - Federata e Kajakimit e Kosovës (FKKS) është bërë sot anëtare me të drejta të plota në Federatën Ndërkombëtare të Kajakimit (ICF), në Kongresin Vjetor të ICF-së, që po mbahet në Romë të Italisë. Federata e Kajakimit e Kosovës

është formuar në vitin e kaluar, ndërsa sporti i kajakimit ka traditë në Kosovë që nga viti 1948. "Sot nga delegatët e Kongresit u votua pranimi i FKKS-së në ICF dhe në këtë mënyrë u hap edhe një derë ndërkombëtare më shumë për sportistët kosovarë. Duke

respektuar misionin e ICF-së si lidere globale që kujdeset për frymëzimin dhe aktivizimin e njerëzve që të merren me kajakim, ne si Federatë për Kajakim e Kosovës do të jemi pjesë e këtij rrugëtimi. Ne ndihemi krenarë që patëm mundësinë të vendosim 'një

tullë' më shumë në 'themelin' e shtetit të Kosovës", ka thënë Visar Emiri, kryetar i Federatës së Kajakimit të Kosovës. KOK-u përgëzon FKKS-në për anëtarësimin në ICF, ndërsa garuesve të kajakimit u uron fat dhe suksese në garat ndërkombëtare.

Ministri Çeku u ofron mbështetje karateistëve

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Ekipi i përfaqësueses së Kosovës në karate dhe përfaqësuesit e Federatës së Karatesë janë pritur në takim nga ministri i MKRS-së, Hajrulla Çeku dhe zëvendësministrja Daulina

Osmani. Duke i uruar për suksesin që kanë treguar në një garë me kaq shumë konkurrencë, ministri Çeku i siguroi ata që mbështetja institucionale nuk do t'u mungojë, ndërsa i ka

përgëzuar për punën që po bëjnë me kaq shumë përkushtim. Karateistët e Kosovës, pjesëmarrës në Kampionatin Ballkanit të karatesë që u mbajt në Poreq, Kroaci, arritën

të marrin katër medalje. Një medalje të argjendtë e mori Elhami Shabanin dhe tri të bronzta, Fortesa Orana, Herolind Nishevcu, si dhe në ekipore, konkurrenca e meshkujve.



Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

NYON, 4 NËNTOR - Janë zhvilluar ndeshjet e xhiros së katërt në fazën grupe të Ligës së Kampionëve. UEFA ka publikuar formacionin me lojtarët më të mirë të këtij raundi në ligën më

prestigjioze evropiane. Robert Lewandowski që kontribuoi me tre gola në fitoren 5-2 të Bayern Munchenit ndaj Benficës është vendosur në qendër të sulmit. Në krah me polakun është edhe Cristiano

Ronaldo që me dy golat e tij shmangu humbjen e Manchester Unitedit (2-2) në udhëtim tek Atalanta. Ndërsa portieri më i mirë i javës është zgjedhur ai i Benficës që pranoi pesë gola kundër

Bayernit, Vlachodimos. Formacioni: Vlachodimos, Alexander-Arnold, Baku, Cancelo, Nkunku, Wijnaldum, Capoue, Pedro Goncalves, Ronaldo, Dybala, Lewandowski.



Xavi: Dua të kthehem te Barcelona

BARCELONË, 4 NËNTOR - Janë orë vendimtare të kthimit të Xavit te Barcelona. Ish-mesfushori i katalansve pritet të marrë vendin e lënë bosh nga Roland Koeman në stolin blaugrana dhe, sipas shtypit spanjoll, do të takohet personalisht me sheikun Mohammed bin Khalifa Al Thani, president i Al Sadd, për ta negociuar largimin e tij nga Katar. "Pres me padurim të kthehem në shtëpi, por është një çështje respekti. Kam një kontratë dhe dy klubet duhet të pajtohen", ka thënë Xavi pas barazimit 3-3 të skuadrës së tij Al Sadd kundër Al Duhan.

Ish-futbollisti drejton ekipin në Katar nga 2019-ta dhe ka ende edhe dy vjet në kontratë. Barcelona dërgoi zëvendës-presidentin Rafa Yuste dhe drejtorin sportiv Mateu Alemany në Doha për të negociuar. Ai që ka frenuar entuziazmin e spanjollëve është administratori i deleguar i Al Saddit, Turki Al-Ali, që deklaroi: "E mirëpritëm vizitën e



delegacionit të Barcelonës, por pozicioni i klubit është i qartë që në fillim: duam ta mbajmë trajnerin tonë dhe nuk mund ta lëmë të largohet në këtë moment delikat të sezonit". Xavi është parë të përshëndetet me lojtarët pas përfundimit të ndeshjes.

Trajneri i ekipit të dytë të Barcelonës, Sergi Barjuan, duhet të qëndrojë në drejtim të skuadrës për ndeshjen e La Ligas që Barça do të luajë të shtunën kundër Celta Vigos. Xavi pritet ta marrë drejtimin e skuadrës gjatë pushimit për ndeshjet e kombëtareve.

SHKURT

Broja rikthehet nga lëndimi

Sulmuesi i talentuar i kombëtares së Shqipërisë dhe skuadrës angleze Southampton, Armando Broja, e ka kaluar lëndimin e pësuar dy javë më parë. 20-vjeçari i mungoi ekipit të tij në dy sfidat e fundit, duke u bërë një mungesë e rëndësishme pasi dëmtimi për Brojën erdhi në momentin më të mirë ku i dha skuadrës katër pikë në dy ndeshje me dy gola të realizuara. Broja shënoi në fitoren ndaj Leedsit vetëm dy javë më parë, ndërsa realizoi dhe në barazimin 2-2 kundër Burnleyt, aty ku edhe u dëmtua. Faqja e Southamptonit ka shpërndarë foto të Brojës në stërvitje me mbishkrimin: "U rikthe!". Southamptoni luan në fundjavë ndaj Aston Villas dhe me shumë mundësi do të jetë një tjetër mundësi për Brojën për ta shfaqur talentin e tij.

Kloppi: Fitore e përkryer ndaj Atletico

Skuadra e Liverpoolit e mposhti Atletico Madridin me rezultat 2-0. Trajneri Jurgen Klopp e ka vlerësuar të përkryer fitoren e skuadrës së tij dhe e vetmja gjë negative në këtë ndeshje ishte lëndimi i sulmuesit Firmino. "Orari ynë ka qenë i jashtëzakonshëm dhe, edhe pse e kontrolluam ndeshjen, ne e humbëm një lojtar shkaku i lëndimit, Bobby Firmino. Mendoj se njerëzit deshën të shihnin shumë gola, por mendoj se ndeshja ishte pothuajse e përkryer ashtu siç duam ne. Ne i shënuam golat në çastet e duhura", ka thënë Klopp.

Varane mungon një muaj

Mbrojtësi Raphael Varane u lëndua në ndeshjen e Ligës së Kampionëve që Manchester Unitedi e barazoi kundër Atalantës (2-2). Francezi u detyrua të largohet nga loja në pjesën e parë të ndeshjes pas lëndimit në kofshë. Pas ekzaminimeve mjekësore është konstatuar se Varane do të mungojë një muaj. Ndeshja kryesore që pritet ta humbasë mbrojtësi francez është derbi kundër Manchester Cityt.

Boksieri 24-vjeçar vdes pas goditjeve në kokë

Boksieri nga Zimbabve, Taurai Zimunya, ka ndërruar jetë si pasojë e goditjeve të shumta që ka marrë gjatë një dueli të zhvilluar në shtetin afrikan. Shumë besojnë se kjo tragjedi mund të ishte shmangur për shkak të reagimit të gjyqtarit, i cili është dashur ta ndërpresë meçin, posa pa që gjendja e 24-vjeçarit u rëndua. Zimunya mori disa goditje të tmerrshme në kokë në raundin e tretë pasa se të rrëzohej. Gjyqtari, megjithatë, nuk reagoi edhe pse dukej qartë se boksieri ishte tronditur rëndë nga goditjet e marra. Lawrence Zimbudzana, sekretari i përgjithshëm i Bordit Kombëtar për Kontrollin në Boks, bëri me dije se do të nisë një hetim për këtë rast. Tauri Zimunya i është ofruar ndihma e nevojshme mjekësore para se të transferohej në spital, por nuk ka mundur të shpëtojë për shkak të tronditjes së rëndë që kishte pësuar.

Superderbi mes Penzës dhe Prishtinës



Pejë, 4 nëntor - Xhiroja e pestë në Superligën e Femrave do të sjellë derbin mes Penzës dhe Prishtinës. Sfida do të zhvillohet të premten në Pejë nga ora 19:00. Të dy skuadrat në këtë edicion kanë nga katër fitore dhe nuk kanë pësuar asnjë humbje, andaj mbetet të shihet cila do të jetë skuadra e pamposhtur në elitën e femrave. Këto dy skuadra u takuan edhe në finalen e Superkupës së Kosovës dhe

Superkupës Mbarëkombëtare, ku fitore shënuan vashat pejane, të cilat janë kampione të Kosovës. Takimet mes këtyre dy

JAVA 5 - SUPERLIGA E FEMRAVE

Të premten takohen:
19:00 Penza - Prishtina

Të dielën takohen:
17:00 Vëllaznimi - Kastrioti
Bashkimi - Trepça (zhvillohet më vonë)

skuadrave kanë qenë shumë interesante në vitet e fundit dhe kështu pritet përballja e së premtes mbrëma.

Të dielën takohen Vëllaznimi dhe Kastrioti, ku skuadra kuqezi ka një fitore dhe tri humbje, ndërsa skuadra ferizajase ka katër humbje në katër ndeshje, duke qenë skuadra e vetme pa fitore në elitë. Ndeshja Bashkimi - Trepça me pajtim të klubeve zhvillohet më vonë.

Unitedi refuzon transferimin e Hazardit

Manchester Unitedi thuhet se ka refuzuar mundësinë për ta transferuar Eden Hazardin nga Real Madridi. Klubi

spanjoll është i hapur për ta shitur sulmuesin belg, i cili nuk ka arritur ta gjejë formën e duhur nga transferimi i

madh nga Chelsea. Hazardi ka qenë më shumë jashtë fushave sesa brenda tyre shkak i lëndimeve të

shpeshta dhe drejtuesit e Realit duan ta largojnë atë. Edhe skuadra e Chelseat nuk është e interesuar për

rikthimin e tij, derisa në opsion mbeten Newcastle Unitedi dhe Tottenham Hotspuri.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr. 464-35834
Datë: 02.11.2021

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligji Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/08 Maj 2009 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91/10 Dhjetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.20/21 Qershor 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 datë 26.09.2008, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. MIRATOHET shpronësimi i pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale Lipjan, sipas Listës së bashkangjitur të këtij Vendimi për arritjen e qëllimit dhe përfitimit të ligjshëm publik për ndërtimin e segmenteve rrugore "Afrim Zhitia" dhe "Mbreti Zog" në Lipjan.

II. Obligohet Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronësoro-Juridik që brenda pesë (5) ditëve të punës t'iu dërgojë Vendimin Përfundimtar personave të identifikuar në këtë Vendim.

III. Pjesë e këtij Vendimi është akti i vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata Pronar apo Zotërues të Interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

IV. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, që brenda afatit prej dy (2) viteve të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.

V. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar, Zyra e Kryetarit e shpall Vendimin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë

VI. Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë-dega në Lipjan çdo person i cili është Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenin 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28 Tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

Page 1 of 3

VII. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

VIII. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtorati për gjeodezi dhe Kadastër është i obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

IX. Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njëri nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

Iu dërgohet:

- Pronarëve ose Zotëruesëve të Interesit
- Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorati për Buxhet dhe Financa
- Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtorati për Shërbime Publike
- Arkivët të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Abujeti



Përshkrimi detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njesisë kadastrale për shpronësim për rrugën "Afrim Zhitia" në Lipjan

K.K. Lipjan Gjendja e vjetër					K.K. Lipjan Gjendja e re				
Nr.	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe e mbetur m ²	Sipërfaqe për rrugë m ²
1	Liridon (Shukri) Ibrahim	002291-3 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	600	Gjërëtanishmi	E re		565	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		35
2	Liridon (Shukri) Ibrahim	02291-4 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	500	Gjërëtanishmi	E re		480	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		20
3	Qëndrim (Shukri) Ibrahim	02291-5 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	450	Gjërëtanishmi	E re		432	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		18
4	Liridon (Shukri) Ibrahim	02291-6 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	450	Gjërëtanishmi	E re		433	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		17
5	"Gashi Invest-Bf" Sh.P.K	02291-2 ZK Lipjan	Arë e kl.2 dhe 4	2456	Gjërëtanishmi	E re		1867	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		589
6	Zdravkoviq (Novice) Zhihorad	00541-0 ZK Lipjan	Arë e kl.4	4899	Gjërëtanishmi	E re		4826	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		73
7	Mushrem (Hamit) Limani	00540-10 ZK Lipjan	Arë e kl.4	500	Gjërëtanishmi	E re		426	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		74
8	Naim (Jahir) Jahiri	00539-6 ZK Lipjan	Arë e kl.4	600	Gjërëtanishmi	E re		576	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		24
9	Hazbi (Hasan) Bytyqi	00539-7 ZK Lipjan	Arë e kl.4	941	Gjërëtanishmi	E re		933	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		8
10	Bajram (Sabit) Gashi	00539-13 ZK Lipjan	Rrugë private	113	Gjërëtanishmi	E re		81	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		32
11	Fatmir (Mustaf) Shahini	00539-23 ZK Lipjan	Arë e kl.4	403	Gjërëtanishmi	E re		371	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		32
12	Bajram (Sabit) Gashi	00538-13 ZK Lipjan	Rrugë private	113	Gjërëtanishmi	E re		2	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		111

Përshkrimi detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njesisë kadastrale për shpronësim për rrugën "Mbreti Zog" në Lipjan

K.K. Lipjan Gjendja e vjetër					K.K. Lipjan Gjendja e re				
Nr.	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe e mbetur m ²	Sipërfaqe për rrugë m ²
1	"Gashi Invest-Bf" Sh.P.K	01889-1 ZK Lipjan	Oborr, shtëpi	406	Gjërëtanishmi	E re		274	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		132
2	Bajram (Sabit) Gashi	02132-3 ZK Lipjan	Oborr, shtëpi, arë e kl.1	2646	Gjërëtanishmi	E re		2230	
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale		416

Page 3 of 3

Handwritten signature

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company

Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 04.11.2021 bënë shpallje publike:

NJOFTIM PËR ANULIM

Shpallje Publike : T-21-008

Anulimi behet për shkak teknike të ndarjes të Lloteve

AUTORITETI KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku inustrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: sales@trepcacorporation.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcacorporation.com		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PRESDNIK OPŠTINE

1 Br.464-35834
Dana:02.11.2021

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4 i člana 11 zakona Br.03/L-139 Ekspropriaciju nepokretne Imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 promene i dopune obavljene sa Zakonom Br.03/1-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Nr.20/21 Juni 2016, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 1Br.110-623 dt 26.09.2008, Predsednik Opštine Lipljan donosi:

ZAVRŠNU ODLUKU

